

Në vëmendjen e SME-ve që operojnë në sektorin e Agro-Industrisë në Qarkun e Vlorës

Të nderuar sipërmarrës,

Auleda, Agjencia e Zhvillimit Ekonomik Lokal ka kënaqësinë të ftojë bizneset që operojnë në sektorin e Agro Industrisë për shfaqjen e ideve të reja të biznesit dhe shërbimeve potenciale me qëllim që të auditojë qëndrueshmërinë teknologjike, teknike dhe ekonomike të idesë tuaj në termat e risive në industrinë ushqimore.

Auleda në bashkëpunim me partnerët e projektit FOCUS do të ndihmojë bizneset lokale për të analizuar kapacitetin e kompanisë tuaj për ide të reja në sektotrin e Agro industrisë dhe për të marrë udhëzime për përmirësimin e performancës së ideve në këtë sektor.

Këto shërbime do t'ju ofrohen nëpërmjet telefononit, takimeve ballë-për-ballë, dhe takimeve me ekspertë dhe konsulentë në fushën e Agro-ushqimit dhe inovacionit.

Pas takimeve do të merrni një dokument në formë raporti ku do të pasqyrohen gjetjet kryesore në lidhje me kapacitetin e inovacionit të kompanisë dhe rekomandimet për përmirësimin e performancës së idesë së biznesit të ri apo të projektit tuaj në sektorin e agro-industrisë.

Nëse jeni të interesuar që idetë tuaja për biznese të reja ose produkte të reja të shqyrtohen dhe analizohen nga projekti FOCUS, Ju lutemi të dërgoni një shprehje interesi (formulari bashkëngjitur kësaj ftese) me të dhënat tuaja (emri, email, numri i telefonit).

Ju falenderojmë paraprakisht për përkushtimin Tuaj të deritanishëm në projektin FOCUS,

Me respekt  
Mirela Koçi  
Drejtoreshë Ekzekutive

\*Ky shërbim ofrohet në kuadër të projektit FOCUS " Forcimi i konkurrueshmërisë së SME-ve agro-ushqimore nëpërmjet KLAS-ave Ndërnacional" nga AULEDA\_Agjencia e Zhvillimit Ekonomik Lokal,Vlorë.